




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-0/DPK
Nr. i taq. Broj stranica Nr. pages	04
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	01-1903/14
Data Datum Date	28-05-2014
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	28.05.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Gazmend RUSHITI Shef i Prokurimit në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës
CC:	z. Nijazi GASHI Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizim me pajisje mjekësore"

I nderuari z. RUSHITI ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin me titull “ Furnizim me pajisje mjekësore”, me nr. Prokurimi: 701-14-081-111, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “ Furnizim me pajisje mjekësore” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) si autoritet kontraktues, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull “Furnizim me pajisje mjekësore”, me nr. Prokurimi:701-14-081-111,e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 17.04.2014, në Procedurën e Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, përmes Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë ekzaminimit të kësaj procedure të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me Procedurat e Prokurimit të cilat rregullohen me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional pika 5, Autoriteti kontraktues ka kërkuar dëshmi nga operatorët ekonomik se produktet e ofruara janë të prodhuara ose të regjistruara për qarkullim dhe shitje në shtetet e **BE, SHBA, Kanada, Australi, Zvicra, Izrael, Japoni.**

Autoriteti Kontraktues me formulimin e kësaj kërkesë ka përcaktuar origjinën e këtyre pajisjeve. Me përcaktimin e vendit të origjinës për pajisjet furnizuese, mund të favorizohen Prodhues apo Operator të caktuar Ekonomik dhe në të njëjtën kohë diskriminohen të tjerët. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që pajisja të jetë e kualitetit të lartë apo ti referohet një standardi vendor, europian ose ndërkombëtar për furnizim me këto pajisje, por assesi nuk lejohet të kërkojë nga ndonjë vend i caktuar. Bazuar në legjislacionin e Republikës së Kosovës i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik, një gjë e tillë nuk është e lejuar dhe nuk i jep hapësirë konkurrencës së lirë dhe të ndershme.

Në Dosjen e Tenderit dhe Kërkesën e njësisë kërkuese, që ka përgatitur A.K. për këtë aktivitet të prokurimit, tek pjesa e specifikimeve teknike të detyrueshme, AKK ka vërejtur se disa përshkrime të specifikimeve teknike të përgatitura nga njësia kërkuese janë favorizuese për një prodhues dhe në të njëjtën kohë specifikimet e tilla i eliminojnë disa prodhues tjerë të këtyre pajisjeve mjekësore.

Në pjesën e Specifikimeve teknike të dosjes së tenderit lot 1 pika a) ku është kërkuar monitor i pacientit me 5 parametra, Autoriteti kontraktues ka përshkruar disa specifikime si në vijim: Tek pika 4. **ECG, arrhythmia and heart rate** the monitoring solution's ECG waveforms sweep speed should be adjustable from 12.5mm/s, 25 mm/s or 50 mm/s. **9. Temperature** The monitoring solution will be capable of monitoring temperature ranges from 0 to +50 in Celsius or 32 to 122 in Fahrenheit, **10. Respiration and apnea** the monitoring solution's respiration and apnea alarms will accommodate all patient populations and acuity with a range of 6 – 150 breaths per minute. The gain selection for the respiratory waveform should be $\times 0.25$, $\times 0.5$, $\times 1$, $\times 2$, $\times 3$, $\times 4$, $\times 5$. **11. etCO₂** the etCO₂ parameter will be a selectable method to measure respiration. The monitoring solution will be capable of showing the value of etCO₂, FiCO₂ and AËRR on screen. **15. Battery**

The monitoring solution's battery shall support a minimum of 120 minutes of continuous monitoring.

Në pikën b) ku është kërkuar monitor i pacientit me 7 parametra janë përshkruar specifikimet si në vijim: **2. User interface and device connectivity** The monitor solution will provide a touch screen display with resolution of at least 1024 x 768. The monitoring solution will be able to display up to 11 waveforms and provide 120 hours of trend and patient information at the patient's bedside. The monitoring solution will provide a 15" (380mm) color TFT screen. **3. Scalability, flexibility and patient monitoring capabilities:** The monitoring solutions will provide storage of at least 1200 NBP measurement results. The monitoring solution shall have the ability to trend and display all monitored parameters in both a tabular and graphical format for no less than 120 hours. **15. Battery** the monitoring solution's battery shall support a minimum of 120 minutes of continuous monitoring.

Specifikimet teknike që duhet ti kenë këto pajisje janë specifikuar nga njësia kërkuuese në atë mënyrë që i përshtatën vetëm prodhuesit **Dräger** dhe eliminonjë prodhuesit tjerë.

Autoriteti kontraktues më konkretisht Njësia Kërkuuese duhet të ketë kujdes dhe t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të mos jenë me vlera fikse por të caktohet minimum i kërkesave teknike dhe që të jenë të hapura për të gjithë operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimet me pajisje të tilla mjekësore. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Njësia kërkuuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të specifikimeve teknike të mos formulojë specifikime favorizuese për prodhues të caktuar e në të njëjtën kohë kohë ti diskriminojë Operatorët tjerë ekonomik, si dhe të mos caktoj kërkesa të cilat do ti pengonin operatorët ekonomik për të dorëzuar tenderët e tyre.

Gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit AKK vëren se njësia e kërkesës i ka propozuar gjithashtu edhe kriteret e përzgjedhjes e që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, ku përcaktohen qartë funksionet e njësisë kërkuuese dhe njësisë së prokurimit, andaj secila duhet veprojnë konform përgjegjësi që ka.

Agjencia kundër Korrupsionit vëren se në njoftimin për kontratë për lot 1 tek pika a dhe b janë kërkuar monitor të pacientit me 5 parametra, ndërsa në dosjen e tenderit për të njëjtën pjesë tek pika a është kërkuar monitor i pacientit me 5 parametra, ndërsa tek pika b është kërkuar monitor i pacientit me 7 parametra me çka konstatohet qartë se këto kërkesa nuk janë identike çka paraqet mospërputhje në mes njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Agjencia gjithashtu vëren se në Deklaratën e Nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve mungon nënshkrimi i Zyrtarit kërkuës, praktika këto jo të mira dhe në kundërshtim me LPP-në.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042. Nenin 7 Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve nenin 9 Funkcionet e njësisë kërkuese dhe nenin 10 Funkcionet e njësisë së Prokurimit të Udhëzuesit operativ për prokurimin publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

